



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 111, datë 06.08.2019

PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. MARSIDA XHA FERLLARI NË VENDIN
VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA
PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 04.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

| | |
|-------------------------|--------------------|
| Ardian Dvorani | - Kryetar |
| Vitore Tusha | - Zëvendëskryetare |
| Arta Marku | - Anëtare |
| Margarita Buhali | - Anëtare |
| Fatjona Memçaj | - Anëtare |
| Fatri Islamaj | - Anëtar/Relator |
| Eriol Roshi | - Anëtar |

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës **06.08.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATE PËR GJYQTARE
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

Zonjës Marsida Xhaferllari

OBJEKTI:

**Urthërimi i veprimtarisë së kandidatit të zonjës
Marsida Xhaferllari, në vendin vakant për
gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur
nga Presidenti i Republikës në datën
04.03.2019.**

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtarit të Këshillit, **zotit Fatri Islamaj**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”*, Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtares Altina Xhoxhaj.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe zonja Marsida Xhaferllari.

4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtari i Këshillit, zoti Fatri Islamaj.

7. Zonja Marsida Xhaferllari, si njëra ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Marsida Xhaferllari, gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

8. Në datën 10.04.2019, kandidatja Marsida Xhaferllari është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

9. Në datën 15.04.2019, kandidatja Marsida Xhaferllari ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatës.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr.265 prot., datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Marsida Xhaferllari, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr.2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Marsida Xhaferllari e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr.15/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Marsida Xhaferllari dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatës Marsida Xhaferllari dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatës Marsida Xhaferllari, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidatës), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit –FAF, (15) Tirana Factoring &Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigji, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Ttetimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Marsida Xhaferllari.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr.110 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja Marsida Xhaferllari sipas ligjit nr. 138/2015.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1123/78 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Marsida Xhaferllari.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatës Marsida Xhaferllari, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së

Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 121 prot, datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 115 prot, datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 119 prot, datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 116 prot, datë 17.04.2019*).

20. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar në pikën 19 për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

21. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat *nr.5878 prot., datë 25.06.2019; nr.2444 prot., datë 22.07.2019, si dhe nr.730/1 prot., datë 20.05.2019.*

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", me shkresën nr. 113 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Marsida Xhaferllari për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar vendimin nr.272 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Marsida Xhaferllari.

24. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave "b", "c" dhe "d" të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Marsida Xhaferllari në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "c" e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Marsida Xhaferllari.

26. Në datë 26.06.2019 dhe datë 24.07.2019, anëtari i Këshillit, relator i çështjes, i ka kërkuar me shkresë kandidates Marsida Xhaferllari të paraqesë shpjegime me shkrim në lidhje me integritetin e kandidates, duke i vendosur në dispozicion të gjithë dokumentacionin e dosjes me perjashtim të atij të klasifikuar si sekret, pasi nga ana e organeve ligjzbatuese është përcjellë informacion se disponohen të dhëna që ngrenë dyshime mbi mundësinë e ndalimit të kandidimit.

27. Në datën 27.06.2019, në datën 01.07.2019, në datën 05.07.2019, në datën 16.07.2019 dhe në datën 29.07.2019, kandidatja Marsida Xhaferllari ka paraqitur me shkrim dhe në rrugë elektronike shpjegime dhe dokumente shtesë, në lidhje me gjetjet e konstatuara nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

28. Përsa është parashikuar në pikën 26 dhe 27 më sipër, Këshilli me shkresën nr.414 prot., datë 01.07.2019 dhe me shkresën nr.427 prot., datë 12.07.2019 ka kërkuar nga ana e Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar ndihmë administrative në procedurën e kërkimit dhe përpunimit, si dhe për deklasifikimin e informacionit në ngarkim të kandidates Marsida Xhaferllari.

29. Lidhur me kërkesën dhe përpunimin e të dhënave të kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr.1822 prot., datë 04.07.2019 dhe shkresa nr.2444 prot., datë 22.07.2019, shkresa nr.7164 prot., datë 01.08.2019, shkresa nr.2577 prot., datë 02.08.2019, si dhe shkresa nr.2583 prot., datë 05.08.2019*).

30. Gjithashtu për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi ti drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave kandidatja Marsida Xhaferllari ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidates si Ministria e Drejtësisë (*shkresa nr.269 prot., datë 19.04.2019*), Këshillit të Lartë Gjyqësor (*shkresa nr.271 prot., datë 19.04.2019*).

31. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Ministria e Drejtësisë (*shkresa nr.3505/2 prot., datë 03.05.2019*), Këshilli i Lartë Gjyqësor (*shkresa nr.2331/1 prot., datë 25.04.2019*).

32. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtari i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

33. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 06.08.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit të kandidimit të zonjës Marsida Xhaferllari, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

34. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidates Marsida Xhaferllari.

35. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

36. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 06.08.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

37. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

38. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoji mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidates Marsida Xhaferllari.

39. Në thelb, Avokati i Popullit parashtroi se bazuar në relatimin që u parashtrua në lidhje me procedurën e vlerësimit, nga dokumentet e deklasifikuara që u paraqitën për shqyrtim, si edhe nga përgjigjet për pyetjet që dhanë relatorët e vendeve vakante, konsiderojmë se nuk ka as edhe një shkak për të ndaluar kandidaturën e znj. Marsida Xhaferllari, si për kandidimin në vendin vakant për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, ashtu edhe në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

40. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidates, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidates Marsida Xhaferllari për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

41. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteria të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

42. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

43. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr.15/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Marsida Xhaferllari dhe personat e lidhur me të.

44. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatës Marsida Xhaferllari, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
- ç) Nuk ka kryer deklarim të rremë.
- d) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

45. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidatja Marsida Xhaferllari në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi.

46. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshillit i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklaratimet e bëra nga kandidatja Marsida Xhaferllari pranë ILDKPKI me *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

47. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatës Marsida Xhaferllari.

48. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Marsida Xhaferllari ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

49. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidatja Marsida Xhaferllari ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

50. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1123/78 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Marsida Xhaferllari, duke ardhur përfundimet se:

a) Subjekti deklarues Marsida Hysen Xhaferllari, nuk përfshihet në fushën e veprimtë nenit 2 të ligjit nr.138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.

51. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Marsida Xhaferllari, krahas plotësimi të saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *“ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;”*. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

52. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidatja Marsida Xhaferllari ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit *“Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”* parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

53. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresë nr.550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar vendimin nr.272 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Marsida Xhaferllari, duke ardhur përfundimet se:

a) Për zonjën Marsida Hysen Xhaferllari, nga verifikimet e kryera deri tani nuk figurojnë të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të saj, sipas

nenit 29, pika 2 të ligjit nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

54. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Marsida Xhaferllari, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

55. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidatja Marsida Xhaferllari “ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

56. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr.730/1 prot., datë 20.05.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar, të cituara në pikën 50 më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Marsida Xhaferllari:

a) Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale.

57. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.5878 prot., datë 25.06.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh dhe përgjigjja nuk përmban të dhëna që i referoheshin kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, por referonte të dhëna lidhur me informacione të viteve 2001-2002 nga të cilat ngrihen dyshime për pastërtinë e figurës së kandidatës.

58. Anëtar i Këshillit relator i çështjes, duke pasur parasysh natyrën e klasifikuar të informacionit, me shkresën e datës 25.06.2019, ka njoftuar kandidaten Marsida Xhaferllari në lidhje me gjetjet e sipërcituara, duke i bërë të njohur vetëm se nga ana e organeve ligjzbatuese është përcjell informacion i klasifikuar se lidhur me veprimtarinë tuaj disponohen të dhëna që ngrenë dyshime mbi mundësinë e ndalimit të kandidimit, duke i kërkuar të paraqesë shpjegime me shkrim brenda 5 ditëve.

59. Në datë 27.06.2019, kandidatja Marsida Xhaferllari në lidhje me gjetjet e sipërcituara, ka paraqitur një kërkesë për njohjen me informacionin e klasifikuar, pasi sipas ligjit nr.8457 datë 11.02.1999 “për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” ajo zotëron disa çertifikata sigurie “C” tepër sekret.

60. Po kështu, në datën 01.07.2019, kandidatja Marsida Xhaferllari, ka paraqitur shpjegimet e saj në lidhje me njoftimin e dërguar nga Këshilli të cituar në pikën 39 më sipër. Kandidatja ka paraqitur objeksionet e saj lidhur me procedurën e marrjes se të dhenave nga DSIK dhe në mënyrë të përmblodhur ajo pretendon se:

- *Lidhur me kandidimin për Gjykatën Kushtetuese, as ndryshimet kushtetuese, as ligji nr. 99/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8477/2000 'Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" dhe asnjë ligj tjetër, në regjimin tranzitor të tij, nuk parashikon asnjë kompetencë të Këshillit të Përkohshëm për Emërimet në Drejtësi të mbledhë të dhëna të klasifikuara që ngrenë dyshime nga agjencitë ligjzbatuese për figurën e kandidatit, si dhe asnjë kompetencë të agjencive ligjzbatuese të mbledhin të dhëna që ngrenë dyshime mbi figurën e kandidatit.*
- *Në rastin tim, jo vetëm që është fakt i ditur publikisht, por konstatohet lehtësisht edhe nga përmbajtja e shprehjes time të interesit, që i jam nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016. Nuk arrij të kuptoj se përse Këshilli i Përkohshëm ka abstraguuar nga detyrimi ligjor i nenit 283 të ligjit nr. 115/2016 duke kërkuar pranë KPK-së për veprimet verifikuese të rastit tim, ku do të merrte përgjigjen se Grupi i Punës i ngritur në bazë të këtij ligji ka bërë verifikimin sipas ligjit, duke konkluduar me raportin nr.11846 prot., datë 31.10.2017 për pastërtinë e figurës time. Jo vetëm kaq, por në dosjen time të rivlerësimit që administrohet nga organet e rivlerësimit, gjendet i administruar edhe Raporti i Hetimit Administrativ datë 01.02.2019, i hartuar nga KPK, ku gjendet sërish konkluzioni për përshtatshmërinë e figurës time.*
- *Konkretisht, figura ime është verifikuar nga DSIK në proceset e 2009, dhe jam pajisur me certifikatën e sigurisë të kategorisë "C Tepër Sekret" ; jam pajisur me certifikatën e sigurisë "NATO Secret" në datën 28.07.2009; në 2012, DSIK sërish ka verifikuar figurën time; në 2015, DSIK sërish ka verifikuar figurën time dhe jam pajisur me certifikatën e sigurisë të kategorisë 'C Tepër Sekret"; në vitet 2017 - 2019, jam verifikuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016. "*

61. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në kërkesën e kandidatës për njohjen me informacionin e klasifikuar, me shkresën nr.414 prot., datë 01.07.2019, i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për qëndrimin që sipas ligjit mbahet në rastet kur një subjekt me certifikatë sigurie kërkon të njihet me informacion të klasifikuar që përmban të dhëna për këtë person.

62. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.1822 prot., datë 04.07.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi qëndrimin se "nevoja për njohje të informacionit të klasifikuar kuptohet nevoja për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar në kuadrin e një funksioni të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale. Për këtë arsye zonja Marsida Xhaferllari nuk është në kushtet e "nevojës për njohje", prandaj nuk mund të ketë qasje në informacionin e kërkuar të klasifikuar "sekret shtetëror".

63. Në datë 05.07.2019, kandidatja Marsida Xhaferllari, ka paraqitur shpjegimet të tjera ku ka përsëritur objeksionet e saj në raport me procedurën e ndjekur nga KED mbi verifikimin e kushteve dhe kritereve të kësaj kandidatje. Ajo pretendon se KED ka kërkuar, në mënyrë të posaçme të dhëna shtesë për këtë kandidatë pranë DSIK-së dhe KLD-së, duke ngritur dyshime për një trajtim të pa-barabartë në raport me kandidatët e tjerë. Ajo pretendon se KED mund ti drejtohej Presidentit të Republikës lidhur me arsyet e mosdekretimit të saj në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda shumë vite më parë dhe jo KLGJ-së. Gjithashtu pretendon se përse i përket pastërtisë së figurës KED mund ti drejtohej KPK-së

për të administruar raportin përkatës që ka bërë ky institucion gjatë procesit të rivlersimit kalimtar të saj.

64. Nga ana e Këshillit, me qëllim vlerësimin sa më të saktë dhe objektiv të të gjitha të dhënave për këtë kandidatë, dhe për të siguruar një proces transparent edhe me vete kandidatë, me shkresën nr.427 prot., datë 12.07.2019 i është kërkuar ndihmë administrative Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për deklasifikimin e informacioni të kandidatës Marsida Xhaferllari.

65. Ndërkohë, në datën 16.07.2019, kandidatja Marsida Xhaferllari, ka paraqitur shpjegimet të tjera ka përsëritur pretendimet se KED në bazë të Kushtetutës dhe ligjit Nr. 115/2016 nuk duhet të mbledhë informacion të klasifikuar sekret për figurën e saj, si dhe përsërit kërkesën për fshirjen e informacioneve të ardhura nga DSIK në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

66. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 2444 prot., datë 22.07.2019, ka njoftuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se me vendimin nr.189 datë 18.07.2019, është bërë deklasifikimi i informacionit të kandidatës Marsida Xhaferllari, për shkresën Nr.5878 datë 25.06.2019, të nivelit “sekret”.

67. Nga ana e relatorit të çështjes, është njoftuar kandidatja Marsida Xhaferllari, e cila në datë 29.07.2019, ka paraqitur shpjegimet të tjera dhe parashtron se:

I qëndron të gjitha propësimet të paraqitura më përparë në KED përse i përket procedurave të ndjekura nga ky organ në kuadër të verifikimeve të bëra për këtë kandidatë, dhe pretendon paligjshmërinë e të dhënave të paraqitura nga DSIK pranë KED-së.

*Kandidatja pretendoi se; “... në dy aktet e paraqitura nga DSIK konstatohet lehtësisht pathemeltësia e saj apo thënë ndryshe pavërtetësia e saj, për arsytet e mëposhtme;
Së pari, fjalia e përsëritur në secilën prej dy akteve të DSIK-së nuk shoqërohet nga asnjë e dhënë mbi burimin nga është nxjerrë dhe nuk tregon se cili organ shtetëror e ka administruar këtë të dhënë, duke pamundësuar objektivisht çdo propësim mbi ligjshmërinë e të dhënës në drejtim të kompetencës së organit që e ka mbledhur dhe të kompetencës ligjore të këtij organi. Fjalia e përsëritur nuk tregon asnjë fakt konkret, asnjë ngjarje konkrete, asnjë sjellje konkrete, asnjë veprim konkret, asnjë mosveprim konkret dhe asnjë pasojë konkrete. Fjalia e përsëritur i referohet në mënyrë të gjeneralizuar një kohe të largët, duke referuar tek vitet 2001 – 2002.....*

Së dyti, fjalia e përsëritur e DSIK-së konfliktohet haptazi me kërkesën e KED-së. Kështu, KED, në tre akte drejtuar DSIK-së kërkon të verifikohet figura ime në drejtim të ekzistencës së “kontakteve të papërshtatshme me krimin e organizuar”. Ndërkohë, dy përgjigjet e DSIK-së, me një fjali tërësisht të pavërtetë, nuk i japin asnjë përgjigje kësaj kërkesë të KED-së, por me zell dhe tendencë të demaskueshme ngre tymnajë mbi integritetin tim.

Së treti, çdo profesionist i ligjit duhet dhe është patjetër në dijeni të konceptit ligjor të provës, sipas të cilit prova është njoftim që merret sipas burimit të parashikuar në ligjin procedural në përputhje me rregullat e caktuara nga ligji dhe që shërben për të provuar një fakt ose një rrethanë në procesin në zhvillim. Fjalia e përsëritur në dy aktet shtesë të DSIK-së jo vetëm që në përmbajtje është hamendësim, por ashtu siç ju kam parashtruar vijimisht në shpjegimet e mia për këtë çështje, për shkak të gjithë veseve procedurale për materializimin e kësaj fjalie në shkresë, ajo haptazi nuk përbën provë për integritetin tim.

Së katërti, jam e detyruar t'ju shpjegoj që për shkak të detyrës zyrtare që kam kryer për monitorimin e shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve për më shumë se 8 vjet (2 vjet pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe 6 vjet pranë KLD-së) kam njohuritë e duhura për të kuptuar absurditetin e dyshimeve që ngre DSIK për figurën time...

Së pesti, duke konfirmuar qëndrimin që kam mbajtur në shpjegimet e mia të datës 01.07.2019, ju rikërkoj që të deklaroni me vendim përshtatshmërinë e figurës time dhe madje, shkallën më të lartë të integritetit. Ky fakt, provohet me 5 procedura të imtësishme verifikimi të figurës të kryera sipas ligjit. Është e rëndësishme të ritheksoj se, i jam nënshtruar procedurës së imtësishme të verifikimit të figurës, në vite të ndryshme, nga administrata e shtetit shqiptar, pavarësisht ngjyrës së partisë politike që ka qeverisur vendin. Jo vetëm kaq, por këto procedura janë bërë sipas ligjit dhe duke marrë gjithë kohën e nevojshme. Ashtu, siç ju kam bërë me dije në shpjegimet e datës 01.07.2019, figura ime është verifikuar në vitin 2009 dy herë dhe kam përfutur çertifikatën e sigurisë "C Tepër Sekret" dhe "NATO Secret"; në vitin 2012 për marrjen e çertifikatës së sigurisë "C Tepër Sekret"; në vitin 2015 dhe kam përfutur çertifikatën e sigurisë "C Tepër Sekret"; në vitet 2017 - 2019, jam verifikuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, ku Grupi i Punës ka konkluduar pastërtinë e figurës time, ndërsa KPK shënon në raportin e hetimit paraprak të datës 01.02.2019 se ka kryer hetime shtesë dhe ka konkluduar për pastërtinë e figurës time....

Procedura e komunikimit të KED me DSIK-në për këtë kandidatë.

68. Duke qënë se shkresa me nr. 5878 prot dt. 25.06.2019 e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ishte përcjellë pranë KED si e klasifikuar sekret shtetëror, KED për të përmbushur detyrimin e tij kushtetues në kuadër të procesit të rregullt ligjor iu drejtua DSIK me shkresën nr. 427 prot., datë 12.07.2019 që në bazë të nenit 22 të ligjit nr. 8457/1999 të ndryshuar dhe nenit 17 të ligjit nr.119/2014 të lejonte që kjo shkresë t'i vihej në dispozicion për njohje kandidates, kjo edhe në bazë të kërkesës për informim të kësaj të fundit.

69. Në kushtet kur DSIK nuk dha lejen për t'u dorëzuar një kopje e shkresës e cilësuar si klasifikuar kandidates, KED iu drejtua DSIK për deklasifikimin e informacionit të përcjellë. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 2444 prot., datë 22.07.2019, ka njoftuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se me vendimin nr.189 datë 18.07.2019 është vendosur deklasifikimin plotësisht të shkresës Nr.5878 prot., datë 25.06.2019.

70. Pra në përgjigje të kërkesës së KED- së, DSIK i përcolli KED-së të njëjtën shkresë fillestare, por duke e cilësuar atë si të deklasifikuar. Kjo shkresë iu komunikua kandidates e cila ka ngritur pretendimet e saj për pavërtetësi të informacionit të përcjellë në këtë shkresë dhe ka kërkuar fshirje të këtyre informacioneve të mbledhura në emër të saj sipas nenit 35 të Kushtetutës.

71. Në vijim Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me qëllim vlerësimin objektiv të të dhënave për këtë kandidatë, me shkresën nr.438 prot., datë 25.07.2019, i ka kërkuar DSIK-së informacion, për njohjen e mëtejshme me të dhënat e klasifikuara, në vijim të procesit të deklasifikimit, në lidhje me shkresën nr.5878 prot., datë 25.06.2019.

72. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.7164 prot., datë 01.08.2019, të klasifikuar si sekret ka kthyer përgjigje.

73. Në vijim Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.2577 prot., datë 02.08.2019, ka deklasifikuar pjesërisht shkresën nr.7164 prot., datë 01.08.2019 dhe përmbajtjen e kësaj shkrese.

74. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr.453 prot., datë 05.08.2019, ka kërkuar informacion, për njohjen me Raportin Nr.11846 prot., datë 31.10.2017, i deklasifikuar me vendimin nr.8, datë 08.01.2018 të KDZH. Ky raport ishte përgatitur në funksion të procesit të rivlerësimit të kandidatës Marsida Xhaferllari nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

75. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.2583 prot., datë 05.08.2019, ka kthyer përgjigje, duke dërguar Raportin Nr.11846 prot., datë 31.10.2017, i deklasifikuar me vendimin nr.8, datë 08.01.2018.

Vleresimi i KED lidhur me pretendimet e kandidatës dhe për përmbajtjen e shkresave të DSIK-së;

76. Kandidatja, siç u citua më lart, ka ngritur pretendime edhe për paligjshmëri të procedurës së mbledhjes së të dhënave ndaj saj nga KED. Lidhur me këtë pretendim KED çmon se marrja e informacioneve nga DSIK është bërë në përputhje me vendimin nr.4/2019 të KED-së duke iu marrë pëlqimi paraprak të gjithë kandidatëve. Po ashtu shkresa për verifikimin e pastërtisë të figurës e drejtuar nga KED-së ndaj DSIK-së ka qënë e shoqëruar me listën e të gjithë emrave të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, si nje procedure e barabartë të gjithë kandidatët.

77. Gjithashtu në mbështetje të pretendimeve të saj për pastërtinë e figurës kandidatja ka paraqitur 4 çertifikata sigurie të lëshuara në emër të saj nga autoritetet ligjzbatuese të lëshuara duke filluar nga viti 2009, 2012, 2015 dhe raportin e DSIK-së të administruar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit sipas të cilit relatohet përshtatshmëria e saj për vijimin e detyrës. Pra nga vetë kandidatja janë paraqitur pranë KED-së një sërë aktesh nga rezulton se figura e saj i është nënshtruar disa herë me rradhë kontrollit të vazhdueshëm dhe në cdo rast është konkluduar për pastërtinë e figurës së saj.

78. Ndërkohë KED mban parasysh faktin që nga DSIK në kuadër të deklasifikimit të informacionit të shkresës Nr.5878 prot, të datës 25.06.2019 dhe shkresës nr.7164 prot., datë 01.08.2019 të dërguar pranë KED, nuk është paraqitur ndonjë e dhënë konkrete apo provë kundër pastërtisë e figurës së saj në kuptim të nenit 38/1 dhe 38/4/a të ligjit nr.84/2016 dhe të orientimit detyrues të dhënë në vendimin të Gjykatës Kushtetuese nr.2/2017 pika 37.

79. Gjithashtu nuk rezulton nga asnjë institucion i ndjekjes penale apo Agjenci ligjzbatuese që të ketë të dhëna konkrete apo prova të cilat të çënojnë figurën morale dhe integritetin e kandidatës Marsida Xhaferllari.

80. KED mban parasysh dhe faktin që kandidatja i është nënshtruar paraprakisht verifikimit nga komisioni i pavarur i kualifikimit (KPK) , KED administroi edhe raportin e DSIK-së të dorëzuar për kandidaten gjatë procesit, të rivlerësimit nga rezultoi se i njëjti institucion pra, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, kishte informuar komisionin e pavarur të kualifikimit për përshtatshmërinë e figurës së kandidatës për vijimin e detyrës në kuptim të nenit Dh të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016. Në bazë të nenin 282/2 të ligjit nr.115/2016

raporti i komisionit të pavarur të kualifikimit lidhur me pastërtinë e figurës së kandidates duhet të mbahet në konsideratë nga KED, pasi Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njihet si *organ mbështetës i KED-së, për zbatimin e parashikimeve dhe procedurave ligjore të ligjit "Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"* edhe për juristët.

81. Duke mbajtur në konsideratë të gjitha aktet e administruara në kuadër të procesit të verifikimit të figurës së kandidates në kuptim të nenit 86 e 87 të vendimit nr.4 dt.11.03.2019, KED vlerëson se informacioni i përcjellë nga DSIK me shkresat Nr.5878 prot, të datës 25.06.2019 dhe nr.7164 datë 01.08.2019, në gjëndjen që paraqitet, nuk provon ekzistencën e rrethanave skualifikuese nga kandidimi. Gjithashtu KED mban parasysh dhe faktin se në mungesë të të dhënave konkrete kundër pastërtisë së figurës së kandidates, kohës së largët konkretisht vitit 2002 që referon informacioni, pra më shumë se 10 vjet më parë se periudha e verifikimit të pastërtisë së figurës (sipas nenit Dh të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016, detyrimin e KED për respektimin e të njëjtit standart kontrolli të informacioneve mbi pastërtinë e figurës si për magjistratët dhe juristët në kuptim të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetute dhe praktikës së KPK në raste të ngjashme), konfirmimit zyrtar nga prokuroria se kandidatja sipas nenit 236 të ligjit nr.115/2016, kandidatja nuk ka qënë asnjëherë në procedim penal, KED vlerëson se nuk ka shkaqe për ndalimin e kandidimit të saj në postin vakant të gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.

82. Për sa i përket pretendimit të kandidates për fshirjen e informacionit të dërguar nga DSIK si i pavërtetë, KED vlerëson se nuk ka kompetencë të shqyrtojë këtë kërkesë sipas ligjit. Qëllimi i veprimtarisë së KED-së në mbledhjen e informacioneve nga institucionet ligjzbatuese është verifikimi i kushteve të kandidimit sipas ligjit nr.115/2016 për efekt të lejimit ose ndalimit të kandidimit, bazuar në ligjin nr.115/2016 dhe në vendimin nr.4/2019 të KED-së, duke i marrë paraprakisht pëlqimin kandidatëve për kërkimin e këtyre informacioneve. KED vlerëson të dhënat e mbledhura nga institucionet bashkëpunuese në raport me të gjitha provat e tjera duke vendosur në përfundim lejimin ose ndalimin e kandidimit. Pra kontrolli i KED mbi këto informacione të përcjella nga institucionet e tjera fokusohet vetëm te vlerësimi i tyre si burim prove ose jo për qëllime të kandidimit. Vërtetësia ose jo në thelb e informacioneve të organeve të tjera nuk është objekt shqyrtimi i KED por i vetë institucioneve që i kanë lëshuar ato. Për më tepër në rastin e akteve të DSIK, KED e ka të pamundur të verifikojë vërtetësinë ose jo të informacioneve të këtij institucioni për aq kohë sa burimi i tyre konsiderohet sekret nga vetë organi, që e ka përcjellë këtë informacion. Për këtë kategori aktesh, kandidatja ka të drejtë ti drejtohet për fshirje DSIK, si organi, që administron të dhënat bazuar në nenin 13 të ligjin nr.9887/2008.

83. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, si përfundim, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Marsida Xhaferllari nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

84. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave "b", "c" dhe "d" të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidatja Marsida Xhaferllari në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e

Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidatja ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të saj.

85. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton sekandidatja Marsida Xhaferllari ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1993 - 1997 si Juriste, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidatja Marsida Xhaferllari nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

86. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Marsida Xhaferllari ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Gjyqtare, për periudhën “*Tetor 1999 – Dhjetor 2007*”, pranë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier;
- b) Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë, për periudhën “*Dhjetor 2007 – Gusht 2008*”, pranë Ministria e Drejtësisë;
- c) Drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit, për periudhën “*Shtator 2008 – Gusht 2011*”, pranë Ministria e Drejtësisë;
- ç) Drejtore e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë, për periudhën “*Gusht 2011– Janar 2013*”, pranë Ministria e Drejtësisë;
- d) Kryeinspektore, për periudhën “*Janar 2013 – Aktualisht*”, pranë Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

87. Bazuar në gjetjet e cituara në pikën më sipër, Këshilli konstaton se kandidatja Marsida Xhaferllari ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

88. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të *mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, sikurse parashtrohet në pikën më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se kandidatja Marsida Xhaferllari nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Marsida Xhaferllari nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

89. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të *mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e

kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike, Këshilli konstaton se kandidatja Marsida Xhaferllari nuk kambajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Marsida Xhaferllari nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

90. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidatja Marsida Xhaferllari nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë kandidatja Marsida Xhaferllari nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

91. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Nëmbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 1 të nenit 199, shkronjës “e” të pikës 2, (të) pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Marsida Xhaferllari.
3. Kandidatja Marsida Xhaferllari ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI



Mendim
për motivimin e lejimit të kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari

Në cilësinë e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në ndryshim nga arsyetimi dhe përfundimet e ardhura në pikat 77 deri 81 të këtij Vendimi mbi motivet ligjore për lejimin e kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari, vlerësojmë se i vetmi arsyetim ligjor që sjell përfundimin e lejimit të kandidimit është se të dhënat tashmë të deklasifikuara të cilat janë vënë në dispozicion të KED-së për verifikimin e integritetit të kësaj kandidateje, pa vendosur aspak në diskutim vërtetësinë e tyre, nuk përmbajnë elementë konkretë që tregojnë se lidhjet, kontaktet apo veprimet abuzive e korruptive të dyshuara apo në ngarkim të kandidatës kanë të bëjnë me lidhje dhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sikurse përcaktohet në pikën 1 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në nenet 34, 38 e 39 të ligjit nr. 84/2016.

Kështu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. 352 datë 20.05.2019, nr. 353 datë 20.05.2019 dhe me nr. 408 datë 25.06.2019, ndërmjet të tjerave, i është drejtuar DSIK me kërkesë për ndihmë administrative në procedurën e kërimit të informacionit të klasifikuar dhe përpunimit profesional të këtij informacioni, nga Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për verifikimin e integritetit të të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, si edhe përcjelljen e këtyre informacioneve pranë KED-së.

Informacioni nga agjencitë ligjzbatuese dhe ndihma administrative nga DSIK është kërkuar lidhur me kushtet vijuese ligjore të kandidimit:

- a) Kandidati nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- b) Kandidati nuk ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Me shkresën “sekret” nr. 5706 datë 24.06.2019 dhe shkresën “sekret” nr. 5878 datë 25.06.2019 (të cilat janë të deklasifikuara plotësisht, sipas kërkesës së KED-së, me vendimin nr. 189 datë 18.07.2019 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” pranë DSIK), DSIK parashtrohet në përmbajtje të njëjtë se:

“Në përfundim të procedurave të verifikimit të Znj. Marsida Xhaferllari, kandidate për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, nga organet kompetente disponohen të dhëna të viteve 2001-2002 ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive duke favorizuar palën nën hetim kundrejt përfitimit financiar”.

KED, me shkresën nr. 438 datë 25.07.2019 i është drejtuar përsëri DSIK-së me kërkesë për ndihmë administrative për njohjen e mëtejshme të plotë ose me informacion më të zgjeruar në lidhje me të dhënat e klasifikuara mbi të cilat janë mbështetur ato të shkresave sekret të deklasifikura të cituara në paragrafin më sipër, sikurse edhe për mundësinë e deklasifikimit të këtyre informacioneve shtesë të klasifikuara që vlerësohet të dërgohen pranë KED nga organet ligjzbatuese.

Në përgjigje të kësaj kërkesë të KED-së, me shkresën “sekret” nr. 7164 datë 01.08.2019 (e cila është deklasifikuar pjesërisht, sipas kërkesës së KED, me vendimin nr. 209 datë 02.08.2019 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” pranë DSIK), DSIK parashtrohet se :

“Në përfundim të procedurave të verifikimit të Znj. Marsida Xhaferllari, kandidate për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, nga organet kompetente disponohen të dhëna të viteve 2001-2002 ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive duke favorizuar palën nën hetim kundrejt përfutimit financiar”.

Sa sipër,

Për Zj. Marsida Xhaferllari është ndarë informacion me institucionet shtetërore (I), konkretisht:

1. Informacionme lëndë “Mbi veprime abuzive dhe korruptive të kryera ngaku përmendet dhe Zj. Marsida Xhaferllari”.
2. Informacion me lëndë “Mbi veprime abuzive të Zj. Marsida Xhaferllaripër mitmarrje duke favorizuar palët nën hetim”.
3. Informacion me lëndë “Mbi veprime abuzive dhe korruptive të Zj. Marsida Xhaferllari”.

(I) Kur organi kompetent krijon bindjen për një shkelje të ligjit, informon institucionet përkatëse, duke mbrojtur burimet dhe metodat informative “

Nga informacionet e sipërcituara të përcjella nga ana e DSIK, përtej të dhënave në ngarkim të kandidates Marsida Xhaferllari si e përfshirë në veprime abuzive e korruptive, madje për të favorizuar palët në hetim, për të cilat KED nuk ka kompetencën të diskutojë e vlerësojë mbi ekzistencën apo vërtetësinë e këtyre të dhënave, gjithashtu KED-së nuk i janë përcjellë të dhëna të mëtejshme më konkrete për natyrën e veprimeve dhe kontakteve të kandidates, as edhe të dhëna më konkrete për të ardhur në përfundimin nëse “palët” apo personat e kontaktuar prej saj përfshihen në kategorinë “Person i përfshirë në krimin e organizuar”, sipas përcaktimeve të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, pikës 15 të nenit 3 dhe kritereve të tjera të neneve 34 e 38 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, mungesa e këtyre të dhënave konkrete mbi rrethin e personave dhe natyrën e veprimeve e të kontakteve të kandidates me ta në vitet 2001 e 2002, të sjellin në përfundim se nuk mund të vendoset ndalimi i kandidimit. Ndalimi i kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese apo për Inspektor i Lartë i Drejtësisë vendoset nga KED kur veprimtaria, veprimet dhe sjelljet e kandidatit/es kualifikohen sipas ligjit si mospërbushje e ndonjërit prej kushteve konkrete ligjore të kandidimit të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji. Nëse jo, të dhënat përkatëse mund të mbahen parasysh nga Këshilli në procedurën e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturës kur shqyrtohen meritat profesionale dhe morale të kandidaturës.

Për sa i përket motive të tjera për lejimin e kandidimit që përmbahen në pikat 77 deri 81 të Vendimit, kemi qëndrimin se ato nuk gjejnë mbështetje në ligj.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi jo vetëm që nuk ka kompetencë të vendosë në diskutim vërtetësinë e informacioneve dhe të dhënave që i përcillen zyrtarisht nga organet kompetente sipas ligjit, por gjithashtu nuk kushtëzohet në përmbushjen e kompetencave të tij për verifikimin e integritetit të kandidaturës thjesht nga fakti i konfirmimit zyrtar nga prokuroria

se kandidatja sipas nenit 236 të ligjit nr.115/2016, kandidatja nuk ka qenë asnjëherë në procedim penal, pajisja e kandidates me certifikatë sigurie “tepër sekret” apo nisur nga koha e largët konkretisht vitit 2002 që referon informacioni, pra më shumë se 10 vjet më parë se perioda e verifikimit të pastërtisë së figurës. Po kështu edhe për përfundimet se raporti i DSIK-së i dorëzuar për kandidaten gjatë procesit të rivlerësimit kishte informuar komisionin e pavarur të kualifikimit për përshtatshmërinë e figurës së kandidates dhe që kandidatja i është nënshtruar paraprakisht verifikimit nga komisioni i pavarur i kualifikimit, për të cilat vlen të evidentohet se në të vërtetë nuk ka vendim konfirmimi në detyrë për këtë candidate, por vendim të një natyre tjetër, ku KPK nuk shprehet lidhur me figurën dhe integritetin e kandidates.

Kemi mendimin se, njësoj sikurse për gjyqtarët dhe prokurorët që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, të dhënat, qëndrimet dhe vlerësimet që institucione dhe organe ligjzbatuese kanë nxjerrë në të kaluarën lidhur me kandidatin/en, edhe pse shqyrtohen e vlerësohen nga KED-ja, gjithsesi nuk e kushtëzojnë procesin e verifikimit të integritetit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Aq më tepër kur praktika dhe procesi i rivlerësimit kalimtar, sikurse edhe praktika e institucioneve të tjera që përzgjedhin e verifikojnë figurën e të emëruarve dhe të zgjedhurve, tregon se në rastet të caktuara janë evidentuar të dhënat të provojnë të kundërtën e atyre që vijë mësisht janë konfirmuar në të kaluarën lidhur me figurën dhe integritetin e subjekteve të verifikuara.

ANËTARRI (KED)

Ante Minku



ANËTARRI (KED)

Artian Domani



Mendim
për motivimin e lejimit të kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari

Në cilësinë e anëtares të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ndaj mendim të ndryshëm me arsyetimin e vendimit në pikat 77 deri 81, në lidhje me vlerësimin e KED-së mbi arsyet e lejimit të kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj e shoh me vend të shpreh qëndrimin tim si më poshtë:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresat nr. 3522 datë 20.05.2019, nr. 3533 datë 20.05.2019 dhe nr. 4083 datë 25.06.2019, midis të tjerave, i është drejtuar DSIK me kërkesë për ndihmë administrative në procedurën e kerkimit të informacionit të klasifikuar dhe përpunimit profesional të këtij informacioni, nga Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për verifikimin e integritetit të kandidatës Marsida Xhaferllari, si edhe përcjelljen e këtyre informacioneve pranë KED-së.

Konkretisht, informacioni i kërkuar DSIK-se, konsiston në ekzistencën e të dhënave në lidhje me:

- a) Kandidati nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- b) Kandidati nuk ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Me shkresat "sekret" nr. 5706 datë 24.06.2019 dhe nr. 5878 datë 25.06.2019 (të cilat sipas kërkesës së KED-së u deklasifikuan plotësisht me vendimin nr. 189 datë 18.07.2019 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret Shtetëror" pranë DSIK), DSIK parashtron se në përfundim të procedurave të verifikimit të Znj. Marsida Xhaferllari "nga organet kompetente disponohen të dhëna të viteve 2001-2002 ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive duke favorizuar palën nën hetim kundrejt përfitimit financiar".

KED-ja me shkresën nr. 4388 datë 25.07.2019 i është drejtuar përsëri DSIK-së për informacion më të zgjeruar në lidhje me të dhënat e klasifikuara si më sipër. Kjo e fundit, pavarësisht kërkesës së KED-së deklasifikoi pjesërisht informacionin e shkresës "sekret" nr. 7164 datë 01.08.2019.

Përtej të dhënave ku ngrihen dyshime në ngarkim të kandidatës Marsida Xhaferllari si e përfshirë në veprime abuzive e korruptive, KED-së, nuk i janë përcjellë të dhëna të mëtejshme më konkrete për natyrën e veprimeve dhe kontakteve të kandidatës, as edhe të dhëna për të ardhur në përfundimin nëse "palët" apo personat e kontaktuar prej saj përfshihen në kategorinë "Personi i përfshirë në krimin e organizuar", sipas përcaktimeve të pikës 11 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, pikës 15 të nenit 33 dhe kritereve të tjera të neneve 34 e 38 të ligjit nr. 84/2016 "Për rrvlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Këto të dhëna nuk përmbajnë elementë konkretë që tregojnë se lidhjet, kontaktet apo veprimet abuzive e korruptive të dyshuara apo në ngarkim të kandidatës kanë të bëjnë me lidhje dhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sikurse përcaktohet në pikën 11 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në nenet 34 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016.

Në zbatim të këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, në mendim tim, mungesa e të dhënave të plotë në informacionet e dërguara KED mbi rrethin e personave, mbi natyrën e veprimeve e kontakteve të kandidatëve, nuk mund të sjellë ndalimin e kandidatit të kandidatës Marsida Xhaferllari për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

ANËTARË E KED

Vitore Tusha

